



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 200/____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

V E N D I M

Nr. 50, Datë 19.08.2019

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË GRAMSH “MBI AUDITIMIN FINANCIAR
DHE TË PËRPUTHSHMËRISË”
(Për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2018)**

Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Gramsh me objekt “Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë”, për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2018, mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, u konstatuan të meta dhe mangësi në funksionimin e disa komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm, devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kundërt.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim përmirësimin e gjendjes.

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit në Bashkinë Gramsh sipas programit të auditimit nr. 200/1prot., datë 27.03.2019, për periudhën 01.01.2017 - 31.12.2018.

II. Të miratoj Opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare.

Për drejtimin e Bashkisë Gramsh.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Gramsh për vitin ushtrimor 2017 dhe 2018, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve , pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i kundërt¹:

Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1700², dhe ISSAI 1200³ përveç efekteve të çështjes përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Kundërt”, pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë Gramsh në datat 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2018, referuar ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore.

Baza për opinion të kundërt:

ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450 shprehet : “Objektivi i audituesit është të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit”

Në planifikim ne kemi llogaritur vlerën e materialitetit duke marrë parasysh riskun e lartë të auditimit ndaj të cilit për të marrë një siguri të arsyeshme, audituesi duhet të tolerojë një normë më të ulët të gabimit material. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiarë të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 është **2,179,047 lekë** dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 është **2,008,028 lekë**. Çdo gabim apo shumë e gabimeve mbi këtë vlerë, e cila përbën gabim material, dhe të përhapur në llogaritë vjetore të vitit 2017 dhe 2018 , në bazë të **ISSAI 1705** përbën bazë për opinion të kualifikuar. Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet në si më poshtë:

31 dhjetor 2017

Llogaria 215 Mjete transporti është nënvlerësuar për 2,745,199 lekë,

Llogaria 218 Inventar Ekonomik është nënvlerësuar për 5,861,889 lekë,

Llogaria 214 Instalime teknike është nënvlerësuar për 7,696,333 lekë,

Llogaria 219 “Amortizim i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara” është mbivlerësuar me 16,303,421 lekë

Llogaria 202 “Studime dhe Kërkime” është mbivlerësuar për 15,303,070 lekë

Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe 212 “Ndërtime dhe konstruksione” janë nënvlerësuar për 15,303,070 lekë,

Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” është nënvlerësuar për 178,620,750 lekë,

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është nënvlerësuar me 1,917,855 lekë,

Llogaria 464 “Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë” është mbivlerësuar me 39,253,506 lekë

Llogaria 7115 “Gjoha, kamatëvonesa, sekuestre e zhdëmtime” është nënvlerësuar me 19,393,618 lekë, me 4,956,844 lekë për vitin 2016 dhe 1,385,763 lekë në vitin 2015, pra një shpërhapje në vite të gabimit

¹**Opinion i kundërt.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale të përhapura.

² Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

³Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi

material

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” është mbivlerësuar me 7,620,935 lekë dhe nënvlerësuar me 43,241,403 lekë,

Llogaria 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është mbivlerësuar me 38,205,248 lekë, dhe nënvlerësuar me 2,894,710 lekë,

Llogaria 486 “Shpenzimet e periudhave të ardhshme” është nënvlerësuar me 23,864,514 lekë,

Llogaria 105 “Teprica e Grandeve kapitale të brendshme” është nënvlerësuar me 212,432,550 lekë,

Llogaria 101 “Teprica (Fond i akumuluar) Deficiti i akumuluar”, është mbivlerësuar me 212,432,550 lekë,

31 dhjetor 2018

Llogaria 215 Mjete transporti është nënvlerësuar për 2,745,199 lekë,

Llogaria 218 Inventar Ekonomik është nënvlerësuar për 5,861,889 lekë,

Llogaria 214 Instalime teknike është nënvlerësuar për 7,696,333 lekë,

Llogaria 210 Toka, troje, terrene është nënvlerësuar për 10,094,547 lekë,

Llogaria 211 Pyje, kullota, plantacione është nënvlerësuar për 2,161,437 lekë,

Llogaria 202 “Studime dhe Kërkime” është mbivlerësuar për 15,303,070 lekë,

Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe 212 “Ndërtime dhe konstruksione” janë nënvlerësuar për 15,303,070 lekë,

Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” është nënvlerësuar për 178,620,750 lekë,

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është nënvlerësuar me 898,331 lekë,

Llogaria 464 “Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë” është mbivlerësuar me 38,152,238 lekë

Llogaria 7115 “Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime” është mbivlerësuar me 1,101,268 lekë

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” është mbivlerësuar me 5,362,156 lekë dhe nënvlerësuar me 31,969,001 lekë,

Llogaria 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është mbivlerësuar me 31,969,001 lekë, dhe nënvlerësuar me 1,646,077 lekë,

Llogaria 486 “Shpenzimet e periudhave të ardhshme” është nënvlerësuar me 40,038,990 lekë,

Llogaria 105 “Teprica e Grandeve kapitale të brendshme” është nënvlerësuar me 159,213,329 lekë,

Llogaria 101 “Teprica (Fond i akumuluar) Deficiti i akumuluar”, është mbivlerësuar me 159,213,329 lekë

Gabimet materiale janë individualisht dhe si shumë mbi nivelin e materialitetit të përcaktuar për vitin financiar të mbyllur në 2017 (materialiteti **2,179,047 lekë**) dhe në 2018 (materialiteti **2,008,028 lekë**), dhe janë gabime materiale të shpërhapura në llogaritë vjetore të subjektit, fakt ky që përbën bazën e opinionit të kundërt të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit .

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë e procedurave të prokurimit, Bashkinë Gramsh

Ne kemi audituar përputhshmërinë⁴ e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërinë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë).

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e Bashkisë Gramsh, gjatë periudhave ushtrimore të vitit 2017 dhe 2018.

Opinion i kualifikuar

Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të veprimtarisë së Bashkisë Gramsh, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Kualifikuar”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale.

Baza për opinion e kualifikuar:

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; u konstatuan devijime nga kuadri rregullator përse i përket, zbatimin të procedurave të prokurimit të cilat nuk kanë qenë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor në

⁴ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

ISSAI 4200- Objektivi i audituesit në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kundrinë ligjorë dhe rregullator në fuqi, kur auditivi bëhet lidhur me auditivin e pasqyrave financiare.

fuqi, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

- Në zbatimin e punimeve të 4 (katër) kontratave, u konstatuan devijime materiale në zërat e matshëm, fakt që tregon se mbikëqyrja e punimeve të investimeve është një zonë me risk në menaxhimin e investimeve publike, duke evidentuar një dëm ekonomik në vlerën **2,3 milionë lekë**.
- Në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlerë të lartë, u konstatua se në 10 raste me vlerë kontrate 247 milionë lekë, operatori i shpallur fitues paraqet mangësi në plotësimin e kriterëve të DST, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Gramsh.

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Gramsh, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafit drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë në vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Gramsh nuk janë implementuar plotësisht kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si më poshtë:

Mjedisi i Kontrollit - nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, dhe nuk është hartuar një kuadër i plotë rregullash të shkruara për funksionimin e institucionit. Institucioni operon sipas rregullores së miratuar me VKB nr. 16, datë 23.03.2012 me 50 fletë e cila nuk është azhurnuar prej 7 vjetësh si dhe nuk ka evidenca dokumentare ku të jetë miratuar dhe identifikuar deklarata e misionit, objektivat, planet strategjike e vjetore në përmbushje të këtyre objektivave. Gjithashtu nuk kemi siguruar evidencë dokumentare mbi plan-veprimin për arritjen e objektivave të institucionit. Në strukturën organizative të vitit 2017 dhe 2018 ekzistojnë dy sektorë, respektivisht Sektori i Inspektoratit e Mbrojtjes së Territorit dhe Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të cilët janë nën varësinë e Drejtorit të Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit, pra kemi të bëjmë me mungesë në ndarje të detyrave dhe përgjegjësi në drejtorinë e mësipërme. Institucioni nuk ka një sektor të veçantë apo një zyrë të menaxhimit të aseteve, por ky funksion

është mbuluar nga një specialist për vlerësimin financiar të aseteve vendore , pjesë e sektorit të menaxhimit financiar.

Aktivitetet e Kontrollit - Nuk na janë paraqitur evidenca nga ana e titullarit ku të identifikohet nxjerrja e urdhrave për ngritjen e Grupeve të Menaxhimit Strategjik për vitet 2017 dhe 2018, edhe pse në Ministrinë e Financave në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit është raportuar nëpërmjet Raportit për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm si në 2017 dhe në 2018 për ekzistencën e një GMS të ngritur me urdhra nga titullari dhe të përbërë nga 11 anëtarë. Nga ana e nëpunësit autorizues nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut dhe dokumentimin e tij

Vlerësimi i Riskut - Nga ana e titullarit nuk është hartuar një strategji e menaxhimit të riskut për vitin 2017 dhe 2018, manuali dhe harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit e cila duhet të përfshinte të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë. Ndërkohë për minimizimin e riskut të mashtrimit dhe parregullsive, nga nëpunësi autorizues nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e këtyre fenomeneve sipas ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 21.

Informimi dhe komunikimi - Realizohet sipas shkallës së strukturave, nëpërmjet takimeve javore raportimeve mujore, tremujore dhe vjetore ku sipas kërkesave u sigurojnë drejtuesve informacion të rregullt mbi arritjen e objektivave

Përveç kësaj mënyre, informimi realizohet edhe nëpërmjet publikimeve dhe njoftimeve të adresuara për publikun në faqen zyrtare të institucionit.

Monitorimi - Një formë e monitorimit, është deklarata e vetëvlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi i vetëvlerësimit nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk funksionon pasi pikëzimi (nga 1 në 4) është vendosur apriori dhe është joreal, veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin “, i ndryshuar, respektivisht neni 8 9, 10 16, 20, 21, 22 dhe 23, 27; Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin; ligji nr. 90/2012 Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 29; VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” pikat 9, 10 11, 13 ,14 dhe 21; ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin. 66 (*Trajtuar në faqen 30-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Bashkia Gramsh, nëpërmjet Nëpunësit Autorizues dhe Zbatues, të marrë masa për miratimin e një rregulloreje së brendshme të azhurnuar ku të jetë miratuar dhe identifikuar deklarata e misionit, objektivat dhe planet strategjike dhe vjetore në përmbushje të këtyre objektivave si dhe të miratoj plan-veprimin e arritjes së këtyre objektivave. Nga ana e titullarit të nxirën urdhrat për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik. Në strukturën organizative të merren masa që të krijohet sektor i veçantë i menaxhimit të aseteve në përputhje me pikat 9, 10 11, 13 ,14 dhe 21 të VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të bëhet ndarja e varësisë nga e njëjta drejtori e dy sektorëve, respektivisht atë të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit dhe të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Nga ana e titullarit të hartohet strategjia e menaxhimit të riskut, manuali dhe harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit e cila duhet të përfshijë minimalisht proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë, të analizohen prej tij dhe përditësohen kontrollet që synojnë minimizimin e riskut dhe të regjistrohen e raportohen masat e marra për minimizimin e riskut të mashtrimit dhe parregullsive.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Gramsh, në vitet 2017 dhe 2018 janë përjashtuar nga inventarizimi llogaritë, 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje Plantacione”, 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”, 215 “Mjete transporti” dhe aktivet afatshkurtra për këto llogari, nuk ekziston një regjistër kontabël ku të specifikohet analitiku i

llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Për pasojë për llogaritë e mësipërme nuk japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet, duke mos përmbushur parimin e dhënies së opinionit sipas ISSAI 1700 *“Formulimi i Opinioneve dhe Raportimi mbi Pasqyrat Financiare” për seksionin e aktiveve të sipërcituara (Trajtuar në faqen 52-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

2.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Gramsh, të merren masa nga Nëpunësi Autorizues i cili duhet të caktoj Nëpunësin Zbatues të krijojë dhe të mbajë regjistrin e aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Gjithashtu nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata materiale të pa inventarizuara deri më sot.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Gramsh, janë ngarkuar padrejtësisht në kredi të llogarisë 219 *“Amortizim i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”* dhe në debi të llogarisë 1013, *“Pakësim fondesh nga amortizimi i AAGJ”* në mënyrë të padrejtë për secilin vit, 2017 dhe 2018, pra në një vlerë kontabël neto më të ulët përkatësisht për;

- 2,745,199 lekë për 215 *“Mjete transporti”*,
- 5,861,889 lekë për 218 *“Inventar Ekonomik”*,
- 7,696,333 lekë për 214 *“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”*,

Efekti i këtij regjistrimi në Llogarinë 219 *“Amortizim i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”* pasqyrohet edhe në vlerën kontabël neto të aktiveve në Bilancin Kontabël të vitit 2017 dhe 2018 duke mbivlerësuar këtë llogari dhe nënvlerësuar vlerën kontabël neto të aktiveve në vlerën 16,303,421 lekë.

Gjithashtu gjatë vitit 2018, është vënë re amortizimi i AAGJ si përkatësisht, llogaria 210 *“Toka, troje, terrene”* në vlerën 10,094,547 lekë dhe llogaria 211 *“Pyje, kullota, plantacione”* në vlerën 2,161,437 lekë. Kjo ka rezultuar në ngarkim në mënyrë të padrejtë në kredi të llogarisë 219 *“Amortizim i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”*, dhe në debi të llogarisë 1013, *“Pakësim fondesh nga amortizimi i AAGJ”* për vitin 2018, pra në një vlerë kontabël neto më të ulët dhe të nënvlerësuar më përkatësisht;

në vlerën 10,094,547 lekë për 210 *“Toka, troje, terrene”* dhe në vlerën 2,161,437 lekë për 211 *“Pyje, kullota, plantacione”* (Trajtuar në faqen 52-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Gramsh, të merren masa nga Nëpunësi Zbatues për sistemimet në kontabilitet duke debituar llogaritë e aktivitetit përkatësisht sipas shumave të nënvlerësuar (në vlerën 2,745,199 lekë për 215 *“Mjete transporti”*; në vlerën 5,861,889 lekë për 218 *“Inventar Ekonomik”*; në vlerën 7,696,333 lekë në vlerën 10,094,547 lekë për 210 *“Toka, troje, terrene”*; në vlerën 2,161,437 lekë për 211 *“Pyje, kullota, plantacione”*) si dhe duke kredituar kundër partinë, pra llogarinë e nënvlerësuar 1013 *“Pakësim fondesh nga amortizimi i AAGJ”* për totalin. Gjithashtu nga ana e Bashkisë Gramsh të kërkohet në rrugë zyrtare ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sqarim për sa i përket zbatimit të pikës së amortizimit të aktiveve si 210 *“Toka, troje, terrene”* dhe 211 *“Pyje, kullota, plantacione”* në udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Llogaria 202 “*Studime dhe Kërkime*” me vlerë në bilancin kontabël 18,484,267 lekë në fund të vitit 2017 dhe 26,703,627 lekë në fund të vitit 2018, konstatohet se disa studime e projekte në vlerën 15,303,070 lekë, i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluara dhe të trashëguara nga 9 ish Komunat të cilat tashmë janë pjesë e Bashkisë Gramsh dhe nuk janë klasifikuar si Aktive Afatgjata Materiale në llogaritë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, 212 “*Ndërtime dhe konstruksione*” (Trajtuar në faqen 52-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Gramsh, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet duke debituar llogaritë e aktiveve për të cilat është ndërmarrë studimi dhe kërkimi dhe tu shtohet vlerës së këtyre aktiveve, ndërsa në kundërt parti të kreditohet llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” për vlerën totale 15,303,070 lekë.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Aktivet Afatgjata Financiare me llogarinë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*” paraqitet në vlerën zero në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të vitit 2017- 2018 edhe pse Bashkia Gramsh zotëron 100% aksione në pjesëmarrje në “Ujësjetllësi Gramsh” sh.a me vlerë 178,620,750 lekë (Trajtuar në faqen 52-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Gramsh, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjetllës Gramsh” sh.a me vlerë kontabël 178,620,750 lekë në llogarinë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*”.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” është nënvlerësuar në vlerën 337,055 lekë në vitin 2017 dhe në vlerën 810,331 lekë në vitin 2018 për shkak të moskontabilizimit të debitorëve për tatim-taksat dhe është nënvlerësuar në vlerën 1,580,800 lekë për vitin 2017 dhe në vlerën 88,000 lekë për vitin 2018 për shkak të moskontabilizimit të gjobave të vendosura nga IMT-ja. Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” me vlerën 39,253,506 lekë në 2017 dhe në vlerën 38,152,238 në vitin 2018 praktikisht kanë pasur si kundërt parti jo klasat 7, por llogarinë 464 “*Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë*” me të njëjtat vlera, përkatësisht në vlerën 39,253,506 lekë në 2017 dhe në vlerën 38,152,238 në 2018. Kjo gjë ka sjellë mbivlerësimin e 464 “*Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë*” në vlerën 39,253,506 lekë në 2017 dhe në vlerën 38,152,238 në 2018, si dhe nënvlerësimin e llogarisë 7115 “*Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime*” në vlerën 19,393,618 lekë për vitin 2017, në vlerën 4,956,844 lekë për vitin 2016 dhe në vlerën 1,385,763 lekë në vitin 2015 dhe duke e mbivlerësuar llogarinë 7115 “*Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime*” në vlerën 1,101,268 lekë në vitin 2018. Veprimet e mësipërme janë në bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 6, 7, 9 dhe 10 dhe ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 42. (Trajtuar në faqen 52-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Gramsh, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” duke regjistruar gjobat e IMT-së për vlerën 1,668,800 lekë (1,580,800 lekë dhe 88,000 lekë), debitorët e tatim taksave për vlerën 1,147,386 lekë. Gjithashtu të bëhet sistemimi i llogarisë 464 “*Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë*” duke e zhvlerësuar këtë detyrim si dhe të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga gjobat dhe kamatëvonesat në vlerën prej 38,152,238 lekë në 2018, vlerë kjo e panjohur deri në këtë periudhë, në llogarinë 1210 “*Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit*” të vitit në vazhdim. Nga ana e titullarit, të nxiret përgjegjësia në lidhje me mungesën e informimit të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në lidhje me shkresën e debitorëve të gjobave të IMT-së.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila përbëhet nga fatura të pa likuiduara të vitit 2017, është mbivlerësuar në vlerën 4,726,225 lekë duke përfshirë fatura të vitit 2018. Nga të dhënat e nxjerra nga transaksionet e thesarit, nga shpenzimet e vitit 2017 vihen re likuidime faturash me kompetencë 2017 që janë likuiduar kryesisht në muajt e parë të 2018, të cilat nuk janë paraqitur si fatura të pa likuiduara për vitin 2017, duke e nënvlerësuar kështu llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 5,036,155 lekë. Gjithashtu janë keq klasifikuar në këtë llogari disa fatura, likuidimi i të cilave nuk është kushtëzuar nga vendosja e limitit në periudhën nëntor dhjetor 2017 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe kjo ka sjellë një mbivlerësim të detyrimit të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 2,894,710 lekë, shumë kjo që duhej të ishte klasifikuar në llogarinë 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” si llogaria tjetër e faturave të pa likuiduara.

Llogaria 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vitin 2017 me vlerë totale 38,205,248 lekë është kompozuar nga fatura të emetuara përpara vitit 2015 dhe vendime gjykate të prapambetura, çka do të thotë se mos likuidimi i tyre ka ardhur si pasojë e mungesës së fondeve. Por faturat, kontratat dhe vendimet e gjykatës që sjellin detyrime për shkak të mungesës së fondeve, paraqiten veçmas në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Pra kemi një mbivlerësim të 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 38,205,248 lekë dhe nënvlerësim të 467 “Kreditorë të ndryshëm”, me po të njëjtën shumë prej 38,205,248 lekësh. Nga ana tjetër kemi fatura të vitit, likuidimi i të cilave nuk është kushtëzuar nga vendosja e limitit në periudhën nëntor dhjetor 2017 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të cilat duhet të ishin paraqitur në shumën e 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”. Mosparaqitja e tyre në këtë shumë ka bërë të mundur nën vlerësimin e llogarisë me 2,894,710 lekë (Trajtuar në faqen 52-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Gramsh, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të mbivlerësimeve dhe nënvlerësimeve të llogarive 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vitin 2017.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila përbëhet nga fatura të pa likuiduara të vitit 2018, është mbivlerësuar në vlerën 3,716,079 lekë duke përfshirë fatura të vitit 2019. Gjithashtu janë keq klasifikuar në këtë llogari disa fatura, likuidimi i të cilave nuk është kushtëzuar nga vendosja e limitit në periudhën nëntor dhjetor 2017 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe kjo ka sjellë një mbivlerësim të detyrimit të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 1,646,077 lekë.

Llogaria 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vitin 2018 me vlerë totale 31,969,001 lekë është kompozuar nga fatura të emetuara përpara vitit 2015 dhe vendime gjykate të prapambetura, çka do të thotë se mos likuidimi i tyre ka ardhur si pasojë e mungesës së fondeve. Por faturat, kontratat dhe vendimet e gjykatës që sjellin detyrime për shkak të mungesës së fondeve, paraqiten veçmas në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, siç edhe u trajtua më lartë. Pra kemi një mbivlerësim të 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 31,969,001 lekë. dhe një nënvlerësim të 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” me po të njëjtën shumë prej 31,969,001 lekësh. Nga ana tjetër kemi fatura të vitit, likuidimi i të cilave nuk është kushtëzuar nga vendosja e limitit në periudhën nëntor dhjetor 2018 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të cilat duhet të ishin paraqitur në shumën e 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”. Mosparaqitja e tyre në këtë shumë ka denatruar llogarinë në vlerën 1,646,077 lekë (Trajtuar në faqen 52--66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Gramsh, nëpërmjet Nëpunësit zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të mbivlerësimeve dhe nënvlerësimeve të llogarive 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vitin 2018.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” ka pasur si kundër parti llogaritë 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 38,205,248 lekë në vitin 2017 dhe në vlerën 31,969,001 lekë në vitin 2018. Për të njëjtat arsye siç u përmendën dhe më lart, llogaria 486 Shpenzime të periudhave të ardhshme duhet të ketë kundër parti llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe në rastin tonë pas modifikimit të llogarisë 467 të paraqitur më sipër, llogaria 486 Shpenzimet e periudhave të ardhshme duhet të jenë në vlerën 62,069,762 lekë për vitin 2017 dhe në vlerën 72,007,991 lekë për vitin 2018, pra nënvlerësimi që i është bërë kësaj llogarie kap vlerat 23,864,514 lekë për vitin 2017 dhe në vlerën 40,038,990 lekë për vitin 2018 (Trajtuar në faqen 52-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Gramsh, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” për vitet 2017 dhe 2018.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Llogaria 105 “Teprica e Grandeve kapitale të brendshme” duhet të jetë sa vlera e 23 “Shpenzime për rritjen e Aktiveve të Qëndrueshme” dhe përkatësisht me vlerë 212,432,550 lekë për vitin 2017 dhe në vlerën 159,213,329 lekë për vitin 2018, por në Pasqyrat e Pozicionit Financiar 2017 dhe 2018 kanë vlerë zero. Pra llogaria 105 “Teprica e Grandeve kapitale të brendshme” është nënvlerësuar në vlerën 212,432,550 lekë në vitin 2017 dhe në vlerën 159,213,329 në vitin 2018. Me të njëjtat shuma është mbivlerësuar llogaria 101 “Teprica (Fond i akumuluar) Deficiti i akumuluar”, shuma e së cilës përveç fondeve bazë, shitesat dhe pikësimet e fondeve, ka përfshirë dhe totalin e llogarisë 105 “Teprica e Grandeve kapitale të brendshme” (Trajtuar në faqen 52-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Gramsh, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 101 “Teprica (Fond i akumuluar) Deficiti i akumuluar” dhe 105 “Teprica e Grandeve kapitale të brendshme” për vitet 2017 dhe 2018.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Njësia Auditit të Brendshëm Publik Bashkia Gramsh, nuk ka audituar aktivitetin financiar të 9 Njësive Administrative, në kundërshtim me VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik (Trajtuar në faqen 30-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Për këtë rekomandimë: Njësia e Auditit të Brendshëm Publik Bashkia Gramsh, të parashikojë dhe ushtrojë një auditim për aktivitetin financiar të 9 Njësive Administrative, për periudhën 2015-2019.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se sipas 2 vendimeve të Këshillit Bashkiak Gramsh, respektivisht nr. 59, datë 03.04.2018 “Për miratimin e strukturës organizative për vitin 2018” dhe Vendimit Këshillit Bashkiak nr. 04, datë 10.01.2019 “Për miratimin e Strukturës organizativë për vitin 2019”, Inspektorati i Mbrojtjes Territorit Bashkia Gramsh është në përbërje të Departamentit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, pra në vartësi të Drejtorit Departamentit, ndaj të cilit IMTV ka të drejtë të vendosë Gjobë, sipas ligjit nr. 107/2014 darë 01.10.2014” Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, ndryshuar me ligjin nr. 73/215, datë 09.07.2015 dhe ligjin nr. 28/2017, datë 23.03.2017, neni 52-Kundërvajtjet administrative, pika 1, vendosja e Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit Bashkia Gramsh (IMTV) në përbërje të Departamentit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, pra në vartësi të Drejtorit Departamentit, mendojmë se është në kushtet e konfliktit të interesit, pasi është në kundërshtim me kuadrin ligjor si më poshtë:

1-ligjin nr. 44/2015 Miratuar në datën 30.4.2015”Kodi i Procedurave Administrative” në R.SH, neni 30 -Pengesat ligjore, ku përcaktohet se: Nëpunësi publik ose anëtar i organit kolegjal nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrës, në rastet kur:

a) ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim;

c) nëpunësi publik, ose anëtar i organit kolegjal ose edhe personat e parashikuar në shkronjën "b", të këtij neni, kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në një çështje objektivist të njëjtë dhe me të njëjtat rrethana ligjore me çështjen në shqyrtim;

2-ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike"-Neni 4 Konflikti i interesave 1. Konflikti i interesave është situata në të cilën një nëpunës i administratës publike ka një interes personal të tillë, që ndikon ose mund të ndikojë në paanshmërinë ose objektivitetin e kryerjes së detyrës zyrtare (*Trajtuar në faqen 33-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Për këtë rekomandojmë: Bashkia Gramsh, të propozojë në Këshillin Bashkiak që Inspektorati i Mbrojtjes Territorit të mos jetë në përbërje dhe në vartësi të Departamentit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, por të dalë si strukturë më vete, në vartësi të Kryetarit të Bashkisë.

Menjëherë

13-Gjetje nga auditimi: Nga ana e 9 Njësive administrative të Bashkisë Gramsh, administratorët e Njësive administrative, edhe pse nuk e kanë në kompetencë kanë nxjerrë njoftim vlerësimit tatimore ndaj subjekteve Juridike dhe fizike. Në kundërshtim me:

a. ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", neni 4-Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 2, ku parashikohet se: Zyra e taksave të bashkisë apo komunës vendos e zbaton sanksione për shkelje të procedurave e të detyrimeve fiskale vendore, të përcaktuara në ligjin, nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

b. ligjin, nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, neni 70, E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor pika 3, ku përcaktohet se: Zyra tatimore e qeverisjes vendore ka të drejtë të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor për tatimpaguesit, që klasifikohen si biznes i vogël. Për detyrimet tatimore, të lidhura me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, njoftimi i vlerësimit tatimor nxirret nga drejtoria rajonale tatimore (*Trajtuar në faqen 33-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1. Për këtë rekomandojmë: Bashkia Gramsh në Rregulloren e Brendshme punonjësit e taksave të 9 Njësive administrative të përcaktojë detyra dhe vartësinë e inspektorëve të taksave në Njësitë administrative të kenë vartësi dyfishe nga Administratori i Njesisë dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, Përgjegjësi i sektorit Taksave në Bashkinë Gramsh. Njoftim vlerësimit tatimore të nxirren vetëm nga Sektori i Taksave bashkia Gramsh dhe jo si deri tani të cilat janë nxjerrë jashtë kompetencave nga Administratori i Njesisë Administrative.

Menjëherë

14-Gjetje nga auditimi: Bashkia Gramsh edhe pse ka mazhorancën e aksioneve në Ujësjiellës sh.a Gramsh dhe për vitet 2017-2018, ka në Këshillin e Administrimit 1, punonjës dhe konkretisht, sekretar i përgjithshëm i Bashkisë Gramsh, edhe pse Këshilli Bashkiak me vendimin nr. 99, datë 18.12.2017, ka caktuar Ujësjiellësin sh.a. Gramsh. Për mos gjetjen e dakortësisë me Administratoren e Ujësjiellësit sh.a Gramsh, nuk ka mundur të realizimin e lidhjes së një marrëveshje, në të cilën Ujësjiellësi sh.a. Gramsh të përcaktohej si agjent tatimor për arkëtimin e taksave vendore së bashku me faturat e ujit të pijshëm, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5 shkronja (ii), neni 7, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore" i ndryshuar, pikës 7.1 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore" i ndryshuar, marrëveshje e cila do të rriste arkëtimin e taksave vendore dhe do rigjenerojë të ardhura për Bashkinë Gramsh (*Trajtuar në faqen 33-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1. Për këtë rekomandojmë: Bashkia Gramsh ti kërkojë Ujësjiellësit sh.a. Gramsh të zbatojë vendimin nr. 99, datë 18.12.2017, në të cilën Ujësjiellësi sh.a. Gramsh në bazë të një

aktmarrëveshje të përcaktohet si agjent tatimor për arkëtimin e taksave vendore së bashku me faturat e ujit të pijshëm, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5 shkronja (ii), neni 7, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, pikës 7.1 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, marrëveshje e cila do të rriste arkëtimin e taksave vendore dhe do rigjenerojë të ardhura për Bashkinë Gramsh.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer, u konstatua se dokumentacioni për pagesën e taksës së tokës dhe taksave të bizneseve në 9 Njësitë administrative, aktualisht nuk ndodhet në Bashki, por në njësitë administrative përkatëse, veprim në kundërshtim me VKM-në nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial” dhe të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit për Çështjet Vendore dhe Ministrit të Financave nr. 3237, datë 16.7.2015 “Për procedurat, afatet kohore, standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial”. Gjithashtu, u konstatua se në regjistrat e kontabilitetit nuk ka të pasqyruar vlerat e debitorëve për këtë taksë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, Dt. 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare” dhe me UMF nr. 8, Dt. 09.03.2018 “Për Paraqitjen e Pasqyrave Financiare në NJQP” (*Trajtuar në faqen 33-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1. Për këtë rekomandimë: Bashkia Gramsh me strukturat përgjegjëse, të marrë masa për grumbullimin e të gjithë dokumentacionit në arkivin qendror të njësisë vendore, në përputhje me VKM-në nr. 510, datë 10.06.2015. Të verifikojë gjendjen në kontabilitet dhe mënyrën e kontabilizimit të detyrimit në ngarkim të familjeve debitorë për taksën e tokës, për periudhën përpara vitit 2015 dhe të kërkojë sipas ligjit, arkëtimin e këtyre vlerave nga personat përkatës.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e pasqyrave financiare konstatohet se totali i faturave të pa likuiduara në fund të vitit 2017 në llog (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën **64,758,273** lekë. Arsyeja e mos likuidimit të këtyre faturave është nga mos realizimi i të ardhurave, mungesa e lëvrimin të fondeve dhe bllokimit të fondeve nga Ministria e Financave në fund të periudhës ushtrimore, rezulton se me buxhetin e vitit 2018, janë likuiduar gjatë detyrime për fatura të pa likuiduara në vlerën 26,553,025 lekë. Për aktivitetin e vitit 2018, gjendja e faturave të pa likuiduara (Llog (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”) paraqitet në vlerën 78,149,685 lekë, për: mallra e shërbime në shumën 54,514 mijë lekë, Investime (art 231), nga FZHR në shumën 13,129 mijë lekë (“Rikonstrukcion Ura Pasarele Nj/Ad Porocan” investim i vitit 2013, në vlerën 3,369,619 lekë, “Ndërtim KUZ Cekin Nj/Ad Pishaj” investim i vitit 2014, në vlerën 2,641,476 lekë dhe “Rikonstrukcion Rruge Bersnik Nj/Ad Kodovjat” investim i vitit 2013, në vlerën 7,117,558 lekë) dhe vendime gjyqësore në shumën 10,507 mijë lekë, nga vlera e detyrimeve si më sipër rezulton se me buxhetin e vitit 2019 është likuiduar shuma prej 45,401,146 lekë, mbetet për likuidim **vlera prej 32,748,539 lekë**, mos likuidimi i detyrimeve vjen në kundërshtim me nenin 52- Kryerja e shpenzimeve, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 9 dhe 10, të ligjit nr. 9928, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar me UMF nr. 5/1, datë 21.05.2014; Udhëzimin udhëzimi plotësues i MF nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 – *Detyrimet e prapambetura të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore (Trajtuar në faqen 33-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

16.1. Për këtë rekomandojmë: Bashkia Gramsh, Drejtoria Ekonomike, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën **32,748,539 lekë**.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, për vitin 2017, shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 1,072,500 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 967,606 mijë lekë ose në masën 90%. Për vitin 2018, shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 998,667 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 906,695 mijë lekë ose në masën 91%. U konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, për sa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”, si dhe UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak (*Trajtuar në faqen 33-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1. Për këtë rekomandojmë: Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Gramsh të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Në vazhdimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Gramsh nuk është bërë e mundur që pas bashkimit me ish-Komunat sot Nj/ Administrative të saj për pronat e transferuara të kryej procesin e regjistrimit në ZVRPP, ngritjen e komisionit për vlerësimin e pasurive me çmimin e tregut të si: truall, tokë bujqësore, ndërtesa, pyje, kullota etj., me qëllim vënien e këtyre pronave në efikasitet për dhënien e tyre me qira për realizimin e të ardhurave nga qiradhënia e tyre dhe për dy Nj/Administrative Tunjë dhe Kukur nuk ka përgatitur dokumentacionin ligjorë për miratimin e listës përfundimtare, të pronave për to. Nuk janë veçuar me regjistër të veçantë pronat të cilat i kanë kaluar në pronësi Bashkisë dhe ato në përdorim. Gjithashtu nuk janë veçuar me dosje të veçanta pronat të cilat janë me probleme, për të cilat kërkohen ndryshime pavarësisht se kanë kaluar në pronësi me vendime përfundimtare nga Këshilli i Ministrave. Për pronat të cilat rezultojnë të zëna forcërisht nuk është çelur dosje e veçantë dhe nuk janë marrë masat e nevojshme për lirimin e saj nga zaptuesit dhe përdoruesit e paligjshëm, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”; pikave 9, 10, 11 dhe 22 të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, dhe kreun III- *Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre* të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (*Trajtuar në faqen 33--52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1. Për këtë rekomandojmë: Bashkia Gramsh të marrë masa për të ngritur grup pune me specialist të fushës, për evidentimin e të gjitha pronave të kaluar me VKM në pronësi të Bashkisë Gramsh, duke bërë evidentimin mbi gjendjen e tyre, dhe përfundimin e procedurave ligjore për regjistrimin në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh dhe kontabilitet. Gjithashtu dhe pronat që janë të regjistruara në kontabilitet, të merren masa për regjistrimin e tyre në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh. Të merren masat dhe të kryhen të gjitha procedurat për mbajtjen e regjistrit kontabël të gjithë

aktiveve që zotëron apo ka në administrim, si dhe regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit, kontrata e qirasë, afati i vlefshmërisë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

Në vazhdimësi

19.Gjetje nga auditimi: KLSH ka dërguar në Bashkinë Gramsh rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. prot 1232/19 datë 05.05.2017, protokolluar në subjekt me shkresën nr. 3227 datë 09.05.2017 **si më poshtë:**

-Janë rekomanduar 16 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 7 masa, janë në proces zbatimi 7 masa, dhe zbatuar pjesërisht 2 masa,

-Janë rekomanduar 17 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar 16 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë disiplinore (*Trajtuar në faqen 112-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Shpërblim dëmi janë rekomanduar 23 masa me vlerë 66,055,927 lekë, ku nga këto:

1. Është pranuar vlera 39,394,821 lekë, nga e cila është arkëtuar vlera prej 5,369,618 lekë, ndërsa shuma prej 27,308,512 lekë deri ne momentin e verifikimit nuk është arkëtuar.

2. Nuk është pranuar vlera prej 26,661,106 leke e cila përbëhet nga vlera prej 7,191,106 lekë, që përfaqëson vlerën e tatim-taksave të pa arkëtuar nga Drejtoria Rajonale Tatim-Taksave Elbasan dhe vlera e rekomandimit nr.2 prej **19,470,000 lekë**, qe i përket **taksës për truallin** të pa vjelur nga Bashkia Gramsh nga subjekti “D. H.” sha” Hydrocentrali i Banjës, për periudhën tetor-nëntor-dhjetor 2016, në kundërshtim me pikën “2/c” të paketës fiskale 2016 miratuar me VKB nr.72, date 21.12.2015 dhe nr. 2. date 25.01.2016, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr.142, datë 17.12.2015 “Për sistemin taksave vendore” neni 23/1 “Taksa mbi truallin” pika 1 dhe 2/ tabela 2.1, ku përcaktohet 12 lekë/m²/ në vit.

Sa sipër, KLSH, rikërkon nga Bashkia Gramsh zbatimin e plotë të këtij rekomandimi, për vjeljen e taksës për truallin për periudhën tetor-nëntor-dhjetor 2016 ne vlerën 19,470,000 lekë, nga subjekti “D. H.” sha” hydrocentrali i Banjës.

19.1.Për këtë rekomandojmë: Kryetari i Bashkisë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak (pas konstituimit) të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të kryer në **Bashkinë Gramsh** për periudhën e veprimtarisë ekonomike 01.01.2017-31.12.2018, duke analizuar të gjitha shkëlqet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësiive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 50-Auditimi i jashtëm pika 4 dhe 5 *ku përcaktohet se: Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht ne këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij.*

Në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -*Të drejtat e KLSH*, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,307,553 lekë, si më poshtë:**

1. Gjetje nga auditimi : Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugës automobilistike nga fshati Shëmrizë deri tek ura Skënderbegas (loti I)”, Bashkia Gramsh, me vlerë të kontratës (me TVSH) 83,999,417 lekë, fituar nga BOE “B.” SHPK & “M.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në **vlerën 729,679 lekë** pa TVSH. Mos kryerja e punimeve është në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2101 prot. datë 30.03.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gramsh dhe “B.” SHPK & “M.” SHPK (Trajtuar në faqen 104-111, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Për këtë rekomandojmë: Nga Bashkia Gramsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **729,679lekë pa TVSH** nga BOE “B.” SHPK & “M.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2101 prot. datë 30.03.2017, me objekt “Rikonstruksion i rrugës automobilistike nga fshati Shëmrizë deri tek ura Skënderbegas (loti I)”, Bashkia Gramsh, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim i Lagjes 85”, Bashkia Gramsh, me vlerë të kontratës (me TVSH) 63,860,304 lekë, fituar nga OE “M.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në **vlerën 218,660 lekë** pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4677 prot datë 16.07.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gramsh dhe OE “M.” SHPK (Trajtuar në faqen 104-111, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Për këtë rekomandojmë: Nga Bashkia Gramsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **218,660 lekë pa TVSH** nga OE “M.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4677 prot datë 16.07.2018, me objekt “Sistemim Asfaltim i Lagjes 85”, Bashkia Gramsh, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugës Lagjia Agjencia”, Bashkia Gramsh, me vlerë të kontratës 11,850,499.83 lekë me TVSH, fituar nga OE “V. K.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **999,291 lekë** pa TVSH. Mos kryerja e punimeve është në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5861 prot, datë 10.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gramsh dhe sipërmarrësit “V. K.” SHPK (Trajtuar në faqen 81-82, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Për këtë rekomandojmë: Nga Bashkia Gramsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **999,291 lekë** pa TVSH nga BOE “V. K.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5861 prot datë 10.09.2018, me objekt “Rikonstruksion i rrugës Lagjia Agjencia”, Bashkia Gramsh, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rehabilitimi i rrugës Devoll”, Bashkia Gramsh, me vlerë të kontratës 62,925,232.80 lekë pa TVSH, fituar nga BOE “E” SHPK & “A.” SHPK, përfaqësuar nga OE “A.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **359,923 lekë** pa TVSH për punime të pakryera dhe punime në kundërshtim me specifikimet teknike të tenderit dhe të kontratës. Mos kryerja e punimeve është në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5032/3 prot, datë 18.07.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gramsh dhe BOE

“E.” SHPK & “A.” SHPK, përfaqësuar nga OE “A.” SHPK (Trajtuar në faqen 104-111, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Për këtë rekomandojmë: Të merren masa nga Bashkia Gramsh, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve OE “A.” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej **359,923 lekë** pa TVSH të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë së defekteve (12.12.2019). Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Gramsh, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).

Menjëherë

B/I. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Sektorit Taksave Bashkia Gramsh dhe 9 Njësitë Administrative, për mos pagimin në afat të detyrimit tatimore subjektet nuk janë ngarkuar të paguajnë gjobë në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. *Neni 114-Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit, pika 1 ku përcaktohet se:* Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj për pagesë, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. Sektori i Taksave dhe Drejtoria e Financës Bashkia Gramsh, nuk kanë rakorduar ndërmjet tyre duke mos kryer akt-rakordimeve për debitorët e taksave për periudhën 01.01.2012 deri më datën 31.12.2018 dhe mos pasqyrimin e saktë në kontabilitet të tyre në vlerën prej **26,902,000 lekë**, në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar dhe pikën 3, të Udhëzimit Ministrit Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e asetëve në sektorin publik”, *Kreu III, paragrafi “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve” (Trajtuar në faqen 33-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Për këtë rekomandojmë: Bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Sektori i Taksave Bashkia Gramsh të nxjerre të gjitha njoftim vlerësimet tatimore dhe për arkëtimin e detyrimeve për vlerën **26,902,000 lekë**, të detajuara në Aneksin nr. 1, si më poshtë:

- Debitorë për qiranë e tokave shtetërore të pandara 8 Fermerë në vlerën141,380 lekë,
- Debitorë nga bizneset 63 subjekte në vlerën.....3,035,833 lekë,
- Debitorët e për taksën e tokës bujqësore nga 4416 fermerë në vlerën15,398,341 lekë,
- Debitorët për taksën e pastrimit Bashkia Gramsh në vlerën.....8,327,214 lekë

Të ndiqen **rrugët e mëposhtme:**

a-**Tu ridërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive** në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, duke shtuar edhe debitorët e taksave të ish komunave.

b-**Ti dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit**, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

c-**Për subjektet të cilët nuk** kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0,06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së

cilës pagesa nuk është kryer, por jo më tepër se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë “ të ndryshuar, me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.

d- Edhe pas njoftimeve zyrtare ne se Bizneset nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Bashkisë (Sektori i Taksave dhe Drejtoria Juridike), pasi te merren masat administrative apo sekuestro te bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,- Mospagimi i taksave dhe tatimeve. **e- Sektori i Taksave në bashkëpunim me 9 Njësitë Administrative,** të audituara respektivisht: **Skënderbegas, Kushovë, Sult, Pishaj, Kodovjat, Kukur, Lenie, Tunjë dhe Kushovë,** të evidentojnë listat emërore te debitorëve ne mënyre elektronike dhe te printuar dhe në zbatim të udhëzimit plotësues të dhe udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pika 98, ku përcaktohet se: *Të gjitha Njësitë e vetëqeverisjes vendore të marin masat e nevojshme për zbatimin e kërkesës ligjore, për njoftimin paraprak të detyrimit tatimor të miratuar me vendim të Këshillit Vendor, për gjithë tatimpaguesit (tatimpaguesit familjarë dhe bizneset, në territorin përkatës),* të njoftojnë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës,/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Gramsh, nuk ka zbatuar VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen. Rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë **64 persona** me vlerë **1,534,341 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Gramsh, sipas Aneksit nr. B. 1/13 (Trajtuar në faqen 33-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Për këtë rekomandojmë: Bashkia Gramsh, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit të marrë masa si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **1,534,341 lekë**.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Gramsh, nuk ka bërë të mundur arkëtimeve të detyrimeve të qirasë për kontratat e lidhura me 25 subjekte private, për sipërfaqen 2360.6 m² për objekte të cilat përdoren për banesa sociale për periudhën e auditimit viti 2017 dhe viti 2018, në vlerën gjithsej **3,475,950 lekë** që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gramsh, veprime në papajtueshmëri me nenin 12 shkronja g, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, me pikën 42, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe me nenin 5 “Pagesa dhe regjimi i saj“ të kontratave, sipas pasqyrës Aneks B. 1/9 bashkangjitur raportit përfundimtar të auditimit (Trajtuar në faqen 33-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit dhe Sektori Juridik, Bashkia Gramsh, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktore prej **3,475,950 lekë**.

Menjëherë

B/II. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: *“Rikonstruktion i rrugës nga fshati Shemrizë deri tek ura Skenderbegas”*, me fond limit **71,756,881 lekë**, me BOE të shpallur fitues **“M.” shpk dhe “B.” shpk**, për vlerën prej 69,999,514 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën **1,757,367 lekë**, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 4 OE dhe 1 BOE është shpallur fituese BOE i cila nuk plotëson kriteret e veçanta, dhe konkretisht pikën 2.3/D për stafin teknik të kualifikuar, pasi rezulton se **NJP** i kërkon punonjësit me dëshmi kualifikimi nga IQT, ndërkohë që i gjithë stafi i paraqitur nuk e ka dëshminë sipas kërkesave të DST, por e ka nga trupë e pavarur certifikuese.

Nga NJP rezulton se janë vendosur Kritere të **ekzagjeruar** të cilat konsiderohen diskriminuese dhe jo në përputhje me vëllimet e punës duke sjell si pasojë dhe 3 ankesa nga operatorë të ndryshëm. Rezulton se kërkesat për licencat profesionale **NP-1C, NP-5C, NP-6B, NP-7C, NP-8A, NP-9C, NP-10A, NPO-11C, NP-12C, NS-1B, NS-2C, NS-4C, NS-8A, NS-13A, NS-16A, NS-17A** janë të paargumentuara pasi nuk ka zëra punimesh për këto kategori si dhe nuk i korrespondojnë vlerës së punimeve; kërkesat për disponimin e Certifikatave ISO nga secili OE në rast bashkimi sipas pikës B të kërkesave për Kapacitetin Teknik në DST, janë në kundërshtim me pikan 3 të nenit 74 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar pasi ato duhet të disponohen në raport me përqindjen në punime;

kërkesat e pikës D të Kapacitetit Teknik në DST ku kërkohen 3 Ing. ndërtimi, dhe 2 ing.mjedisi janë të **ekzagjeruar** në raport me volumin e punimeve, kërkesat për ing. elektrik, ing.hidroteknik, ing.mekanik, ing.elektronik dhe arkitekt janë të paargumentuara pasi nuk ka asnjë zë në preventiv për këtë kategori inxhinierësh.

Kërkesat për 15 kamionë, 4 grejder, ekskavator me krahë 16 m, 4 ekskavatorë me zinxhirë janë të paargumentuara, të ekzagjeruar në raport me volumin e punimeve.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE **“M.” shpk dhe “B.” shpk** të cilët nuk plotësonin kërkesat e DST, është bërë në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 24, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar (*Trajtuar në faqen 66-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Për këtë rekomandojmë: Kryetari i Bashkisë Gramsh, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **69,999,514 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasojë me efekte negative.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE:

C/1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt-konstatimet nr. 8, datë 17.05.2019, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit. Mbështetur në nenet 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 *“Për kundërvajtjet administrative”* dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke

vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore apo administrative), për **10 (dhjetë) punonjës**.

Për Njësinë e Prokurimit 4 punonjës si më poshtë:

1.z. E. K., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik, në cilësinë e Kryetarit të NJP, për procedurat e prokurimit **në 3 tendera** si më poshtë:

“Rikonstruksion i rrugës automobilistike nga fshati Shemrizë deri tek ura Skenderbegas”, zhvilluar me datë 23.02.2017 dhe lidhje kontrate nr. 2101 regj., datë 30.03.2017;

“Rehabilitimi i kanalit vaditës të Otomisë, Njësia Administrative Poroçan”, zhvilluar me datë 17.02.2017 dhe lidhje kontrate nr. 2274 regj., datë 03.04.2017;

“Rehabilitim i rrugës Kodër Zgjupe-Sult, Njësia Administrative Sult”, zhvilluar me datë 21.04.2017 dhe lidhje kontrate nr. 3695 regj., datë 29.05.2017;

2. Zj. E. I., me detyrë Inspektore e IMTV në cilësinë e anëtarit të NJP, për procedurat e prokurimit **në 4 tendera, si dhe**.

3.z. A. Rr., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit në cilësinë e anëtarit të NJP, për procedurat e prokurimit **në 4 tendera** si më poshtë:

“Rikonstruksion i rrugës automobilistike nga fshati Shemrizë deri tek ura Skenderbegas”, zhvilluar me datë 23.02.2017 dhe lidhje kontrate nr. 2101 regj., datë 30.03.2017;

“Rehabilitimi i kanalit vaditës të Otomisë, Njësia Administrative Poroçan”, zhvilluar me datë 17.02.2017 dhe lidhje kontrate nr. 2274 regj., datë 03.04.2017;

“Rehabilitim i rrugës Kodër Zgjupe-Sult, Njësia Administrative Sult”, zhvilluar me datë 21.04.2017 dhe lidhje kontrate nr. 3695 regj., datë 29.05.2017;

“Rikonstruksion i lagjes “Akhensia” Gramsh”, zhvilluar me datë 30.07.2018 dhe lidhje kontrate nr. 5861 regj., datë 10.09.2018.

4. z. E. G., me detyrë Specialist IT në cilësinë anëtarit të NJP për procedurën e prokurimit **në 1 tender** si më poshtë:

“Rikonstruksion i lagjes “Akhensia” Gramsh”, zhvilluar me datë 30.07.2018 dhe lidhje kontrate nr. 5861 regj., datë 10.09.2018.

Për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave 3 punonjës si më poshtë:

5.z. A.Sh., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, në cilësinë e kryetarit të KVO-së për procedurat e prokurimit **në 6 tendera**.

6.z. A. Ç., me detyrë Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit në cilësinë e anëtarit të KVO-së për procedurat e prokurimit **në 6 tendera**.

7.z. Q. P., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve dhe Emergjencave Civile, në cilësinë e anëtarit të KVO-së për procedurat e prokurimit **në 6 tendera të renditura për të tre punonjësit si më poshtë:**

“Ndërtim i urës tip BAILEY, përroi Gurrës, fshati Poroçan”, zhvilluar me datë 20.02.2017 dhe lidhje kontrate nr. 2097 regj., datë 30.03.2017;

“Rehabilitim i rrugës Kodër Zgjupe-Sult, Njësia Administrative Sult”, zhvilluar me datë 21.04.2017 dhe lidhje kontrate nr. 3695 regj., datë 29.05.2017;

“Rehabilitim i rrugës Devoll” zhvilluar me datë 19.06.2017 dhe lidhje kontrate nr. 5032 regj., datë 18.07.2017;

“Rikonstruksion i objektit shkollë 9 – vjeçare “Këshilltarët e Galigatit”, Njësia Administrative Pishaj”, zhvilluar me datë 28.07.2017 dhe lidhje kontrate nr. 5710 regj., datë 30.08.2017;

“Rikonstruksion i shkollës 9 – vjeçare “Koli Baba”, zhvilluar me datë 16.07.2018 dhe lidhje kontrate nr. 5173 regj., datë 17.08.2018;

“Sistemim asfaltim i lagjes 85”, zhvilluar me datë 11.06.2018 dhe lidhje kontrate nr. 4577 regj., datë 16.07.2018;

Për Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave për 6 punonjës si më poshtë:

5.1.z. A. Sh., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm në cilësinë e kryetarit të Komisioni të Shqyrtimit të Ankesave për procedurën e prokurimit **në 1 tender**.

6.1.z. A. Ç., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit, në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Shqyrtimit të Ankesave për procedurën e prokurimit **në 1 tender**.

7.1.z. Q. P., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve dhe Emergjencave Civile, në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Shqyrtimit të Ankesave për procedurën e prokurimit **në 1 tender** si më poshtë:

“Rikonstruksion i rrugës automobilistike nga fshati Shemrizë deri tek ura Skenderbegas”, zhvilluar me datë 23.02.2017 dhe lidhje kontrate nr. 2101 regj., datë 30.03.2017;

8.z. M. A., në cilësinë e Kryetarit të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, për procedurën e prokurimit në 1 tender.

9.z. V. T., me detyrë Specialist për Mbrojtjen e Tokës, Mjedisit dhe Supervizim në Sektorin e Shërbimeve Veterinare, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, për procedurën e prokurimit në 1 tender.

10.z. A. Sh., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile dhe Strehimit, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, për procedurën e prokurimit në 1 tender si më poshtë:

“Rikonstruksion i lagjes “Akhensia” Gramsh”, zhvilluar me datë 30.07.2018 dhe lidhje kontrate nr. 5861 regj., datë 10.09.2018

Për shkeljet e mëposhtme:

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJP ka rezultuar se ato kanë kufizuar numrin e OE pjesëmarrës pasi në hartimin e kriterëve të kualifikimit, NJP nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së kriterëve, siç kërkohet shprehimisht nga VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, gjithashtu, disa nga kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim me llojin e punës së kërkuar (si: numri prej 100 punonjësish duket shumë i madh dhe diskriminues dhe jo në përpjesëtim me volumin e punës dhe afatin e punimeve; kërkesa për lëndë plasëse e paargumentuar; numri i mjeteve apo certifikatave të cilat nuk kanë lidhje me zërat e punimeve që do të kryhen, etj).

Duke patur parasysh se, KVO-ja ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me OE/BOE e tjerë, ku çdo mungesë në dokumentacion, sado e vogël, të konsiderohet mos përmbushje e kërkesave në DST, si edhe faktin që në nenin 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, gjykojmë se vendimet e marra nga KVO për shpalljen fitues të operatorëve ekonomikë edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (këtu e në vijim AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (këtu e në vijim NJHDT), duke mos anuluar këto procedura, veprime këto me impakt negativ në buxhet për procedurat e prokurimit të shpallura dhe mos përputhje me dispozitat e ligjit të prokurimit publik dhe shpallur fitues me kriteret e paplota e konkretisht, janë në kundërshtim me:

- nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa (c, ç, d, dh), nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”,

-nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, si dhe nenin 66, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në 1 nga procedurat e mësipërme, për shkak të kriterëve të vendosura nga NJP, të cilat rezultojnë diskriminuese dhe aspak në përputhje me volumet e punës, kanë bërë që shumë OE të paraqesin ankesa dhe gjithashtu të jenë edhe shkaqe për s’kualifikimin e tyre nga KVO. Kjo e fundit ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE me mangësi në dokumentacion, duke sjellë pasojë me efekte negative në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me

ekonomicitet, efëcence dhe efektivitet të fondeve publike, në vlerën **prej 69,999,514 lekë** pa TVSH, dhe në total në 6 procedurat KVO i ka kualifikuar duke mos përmbushur të gjitha kriteret e vendosura nga NJHDT (*Trajtuar në faqen 64-98, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

C/2. Për Inspektoratin të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) bashkia Gramsh.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Gramsh t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative (gjobë) për 2 (dy) mbikëqyrës punimesh**, si më poshtë:

1.z. E. M., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, gjobë në masën **50,000 lekë** për shkeljet e konstatuara në 3 objektet respektivisht:

-“Rikonstruksion i rrugës automobilistike nga fshati Shëmrizë deri tek ura Skënderbegas (loti I)”, Bashkia Gramsh, me sipërmarrës punimesh BOE “B.” SHPK & “M.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **729,679 lekë pa TVSH**;

-“Sistemim asfaltim i Lagjes 85”, Bashkia Gramsh, me sipërmarrës punimesh OE “M.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **218,660 lekë pa TVSH**;

-“Rehabilitim i rrugës Devoll”, Bashkia Gramsh, me sipërmarrës punimesh BOE “E.” SHPK & “A.” SHPK përfaqësuar nga OE “A.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **359,923 lekë pa TVSH**, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

2.z. L. H., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, gjobë në masën **50,000 lekë** për shkeljet e konstatuara në objektin “Rikonstruksion i rrugës Lagjia Agjensia”, Bashkia Gramsh, me sipërmarrës punimesh OE “V. K.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **999,291 lekë pa TVSH**, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

D. MASA DISIPLINORE:

D/1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, gjerat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Gramsh** që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancës e secilit punonjësi dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2018 dhe për shkelje të *Rregullores së brendshme të organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të administratës së Bashkisë Gramsh, miratuar me vendimin e këshillit bashkiak Gramsh, nr. 16, datë 23.03.2012 neni 68 pika 6.3 Drejtoria ekonomike. neni 69, pika 6.3-sektori i financës, neni 70-Përgjegjësi i sektorit të financës dhe buxhetit, neni 70/1 dhe neni 70/2, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore ndaj **7 punonjësve**, si më poshtë:*

b-“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” e parashikuar në nenin 58 germa (c), të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil, për 6 punonjësit e mëposhtëm:

1.z. A. B., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar,
2. znj. S. M., me detyrë Specialiste e pagave dhe shpenzimeve ne vitin 2017 ka mbuluar edhe vendin e përgjegjësit te financës për periudhën shkurt 2017 deri shkurt 2018 kohe kur K. B. ishte me raport leje lindje.

3.znj. K. B., ish përgjegjëse e Financës nga muaji shkurt 2018 deri 31.12.2019, aktualisht përgjegjëse e zyrës taksave.

4.znj. E. F. specialiste për te ardhurat dhe ndjekjen e debitorëve Prill 2018 në vazhdim.

Të pesë punonjësit e mësipërm kanë qenë apo janë në strukturë të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, **për shkeljet e mëposhtme:**

-Janë përjashtuar nga inventarizimi llogaritë, 210 “*Toka, troje, terrene*”, 211 “*Pyje Plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e Konstruksione*”, 213 “*Rruge, rrjete, vepra ujore*”, 215 “*Mjete transporti*” dhe aktivet afatshkurtra si dhe për këto llogari, nuk ekziston një regjistër kontabël,

-Janë ngarkuar padrejtësisht në kredi të llogarisë 219 “*Amortizim i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara*” dhe në debi të llogarisë 1013, “*Pakësim fondesh nga amortizimi i AAGJ*” në mënyrë të padrejtë për secilin vit, 2017 dhe 2018, pra në një vlerë kontabël neto më të ulët në vlerën 6,303,421 lekë,

-Nuk janë klasifikuar si Aktive Afatgjata Materiale Llogaria 202 “*Studime dhe Kërkime*” në vlerën 15,303,070 lekë, që i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluara dhe të trashëguara nga 9 ish Komunat,

-Nuk janë përfshirë në llogarinë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*” aksionet e “Ujësjetës Gramsh” sh.a me vlerë 178,620,750 lekë, në pasqyrat financiare të vitit 2017- 2018 edhe pse Bashkia Gramsh zotëron 100% të tyre.

- Janë mbyllur pasqyrat financiare të vitit 2017 dhe 2018 me gabime të shumta materiale që përbëjnë shkak të dhënies së një opinioni të kundërt,

-Nuk janë kryer rakordime ndërmjet Drejtorisë Financës dhe Sektorit Taksave, për pasojë më datën **31.12.2018**, paraqitet debitorë në shumën **26,902,000**. Kjo ka ardhur pasi nuk është kryer rakordim periodik dhe nuk janë hapur analizat (partitarët),

Veprime apo mos në kundërshtim me:

- Ligjin 10296 datë 08.07.2010“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar me ligjin 110/2015 dt. 07.11.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”” neni 4 dhe neni 6,

- Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, neni 4, 6, 7, 9, 10,me efekt veprues deri në 31 dhjetor 2018 përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 25 datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”.

-Udhëzimin i MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

-Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

-Për lejimin dhe krijimin e faturave të pa likuiduara dhe vendimeve gjyqësore, pasi për aktivitetin e vitit 2018, gjendja e faturave të pa likuiduara (*Llog (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to*”, dhe detyrime të tjera në llog (467) “*Kreditorë të ndryshëm*”) paraqitet në vlerën **78,149,685 lekë**, respektivisht për vlerën 45,401,146 lekë, që janë fatura të fund vitit 2018(detyrime të faturuara në vlerën 44,552,665 lekë dhe detyrime të pa faturuara për kontrata të lidhura në vlerën 848,481 lekë). Më datën 30.04.2019 kanë mbetur pa u likuiduar fatura të pa likuiduara dhe vendime gjyqësore për vlerën prej 32,748,539 lekë, duke mos zbatuar kërkesat e kuadrit ligjor dhe nënligjor **si më poshtë:**

-nenin 52- *Kryerja e shpenzimeve*, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

-nenin 9 dhe 10, të ligjit nr. 9928, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar;

UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar me UMF nr.5/1, datë 21.05.2014;

Udhëzimin udhëzimi plotësues i MF nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 – *Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*; me përcaktimet e pikës 62 të udhëzimit nr.2, datë 06.02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit dhe me pikën 8, shkronja “b”, si dhe pikën 9 të Udhëzimit Përbashkët nr. 29, datë 18.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv”,

5. Z. A. Ç. me detyrë Drejtor i Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit, për shkeljet e mëposhtme:

-Nuk ka ndjekur të gjithë hapat ligjore për arkëtimin e detyrimeve për kontratat e lidhura me 25 subjekte, për sipërfaqen 2360.6 m², me pasojë mos arkëtimin e detyrimeve në vlerën **3,475,950 lekë**, në kundërshtim me nenin 12 germa g,të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, me pikën 42, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe menenin 5 “Pagesa dhe rregjimi i saj“, të kontratave.

6. Z. Sh. K., Inspektor i Tatim-Taksave, në sektorin e taksave Bashkia Gramshfilluar marrëdhëniet e punës më datë 09.01.2017,për shkeljet e mëposhtme:

Kjo ka ardhur pasi nuk është kryer rakordim periodik dhe nuk janë hapur analizat (partitarët), në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe pikën 3 të Udhëzimit Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011“ Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve”.

-Për mos ndjekje të procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve nga subjektet debitor, në kundërshtim me kërkesat e Kreut XI-*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor*, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë në **vlerën 26,902,000 lekë**.

D/2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas kodit të punës në R.SH.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat (e, ç) e nenit 1, Kreu IV, nenet 37 dhe 144, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” dhe shkronjës (b) e nenit 12- “*Dhënia e masave disiplinore*” ,të kontratës individuale, i **rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Gramsh**, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH –së, për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2018,të fillojnë procedurat për dhënie masë disiplinore për **6(gjashtë) punonjësit e mëposhtëm:**

a-Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna.

Për mos kryerjen e detyrave funksionale të administratës të Njesisë, bazuar ne ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore “, neni 66-Detyrat e administratës së njesisë administrative, ku përcaktohet se : administrata e njesisë administrative b. Mbikqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin, për veprimet apo mos veprimet mbajnë përgjegjësi 6 punonjësit e Njësive administrative Pishaj, Skënderbegas dhe Kukur, si më poshtë:

1.L. Z., Administrator i Njesisë Pishaj filluar marrëdhëniet e punës më datë 22.01.2018.

Pasi, nga të dhënat e paraqitura rezulton se Njësia Administrative **Pishaj** më datën 31.12.2018 ka debitorë për tarifatat dhe taksat vendore pa u likuiduar të ardhura të munguara në vlerën **4,057,068 lekë**, nga e cila 9 subjekte biznesi në vlerën 261,466 lekë, 1104 fermerë nuk

kanë paguar taksën e tokës në vlerën 3,795,602 lekë (Më hollësisht listat e debitorëve paraqiten në ANEKSIN nr. 2/1 bashkëlidhur).

Nga ana e NJA, **Pishaj** nuk njihej gjendja e debitorëve dhe nuk disponoheshin listat e fermerëve të cilët nuk kanë paguar taksën e tokës, pasi nuk është krijuar regjistri për taksapaguesit familjar, në kundërshtim me pikën 7, neni 4, të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Njësia Administrative **Pishaj**, nuk ka njoftuar nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit, në zbatim të pikës 76, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”.

2.G. P., Administrator i Njesisë **Skënderbegas** filluar marrëdhëniet e punës më datë 01.11.2017.

3.H. M., agjent tatimor në Njësinë **Skënderbegas** filluar marrëdhëniet e punës më datë 01.08.2015.

4.M. Ç., inspektor taksash në Njësinë **Skënderbegas** filluar marrëdhëniet e punës më datë 05.06.2018.

Pasi, nga të dhënat e paraqitura rezulton se Njësia Administrative **Skënderbegas** më datën 31.12.2018 ka debitorë për tarifatat dhe taksat vendore pa u likuiduar të ardhura të munguara në vlerën **3,321,048 lekë**, nga e cila 5 subjekte biznesi në vlerën 123,248 lekë, 481 fermerë nuk kanë paguar taksën e tokës në vlerën 3,197,800 lekë. Më hollësisht listat e debitorëve paraqiten në ANEKSIN nr. 2/6 bashkëlidhur.

Nga ana e NJA, **Skënderbegas** nuk njihej gjendja e debitorëve dhe nuk disponoheshin listat e fermerëve të cilët nuk kanë paguar taksën e tokës, pasi nuk është krijuar regjistri për taksapaguesit familjar, në kundërshtim me pikën 7, neni 4, të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Njësia Administrative **Skënderbegas**, nuk ka njoftuar nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit, në zbatim të pikës 76, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”.

5.L. K., Administrator i Njesisë administrative **Kukur** filluar marrëdhëniet e punës më datë 01.08.2015.

6.E. Gj., agjent tatimori Njesisë administrative **Kukur** filluar marrëdhëniet e punës më datë 06.03.2017.

Pasi, nga të dhënat e paraqitura rezulton se Njësia Administrative **Kukur** më datën 31.12.2018 ka debitorë për tarifatat dhe taksat vendore pa u likuiduar të ardhura të munguara në vlerën **2,281,575 lekë**, nga e cila 6 subjekte biznesi në vlerën 103,320 lekë, 920 fermerë nuk kanë paguar taksën e tokës në vlerën 2,041,155 lekë dhe 4 Fermerë nuk kanë paguar për 8.5 ha qiranë e tokës shtetërore të pandarë në vlerën 103,320 lekë. Më hollësisht listat e debitorëve paraqiten në ANEKSIN nr. 2/9 bashkëlidhur. Nga ana e NJA, **Kukur** nuk njihej gjendja e debitorëve dhe nuk disponoheshin listat e fermerëve të cilët nuk kanë paguar taksën e tokës, pasi nuk është krijuar regjistri për taksapaguesit familjar, në kundërshtim me pikën 7, neni 4, të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Njësia Administrative **Kukur**, nuk ka njoftuar nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit, në zbatim të pikës 76, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”.

E. PËR INDICIE PENALE:

Bashkia Gramsh, me kriteret e përcaktuara ka kufizuar numrin e OE pjesëmarrës pasi në hartimin e kriterëve të kualifikimit, NJP nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së kriterëve ka shkaktuar përdorim të fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë për vlerën prej për vlerën **69,999,514 lekë** pa TVSH.

Nga kualifikimi dhe shpallja fitues e OE apo BOE në 6 procedura prokurimi, të cilët nuk kanë plotësuar të gjitha kriteret për kualifikim, procedura për të cilat referuar shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, referuar nenit 248 dhe 281, të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, **dërgohen për veprime të mëtejshme procedurale, për tu studiuar si Indice Penale nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për procedurat e prokurimit si vijon:**

I.Nga auditimi ka rezultuar se Njësia e Prokurimit në 5 procedura prokurimi, me kriteret e përcaktuara ka kufizuar numrin e OE pjesëmarrës pasi në hartimin e kriterëve të kualifikimit, NJP nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së kriterëve, siç kërkohet shprehimisht nga VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, gjithashtu, disa nga kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim me llojin e punës së kërkuar (si: numri prej 100 punonjësish duket shumë i madh dhe diskriminues dhe jo në përpjesëtim me volumin e punës dhe afatin e punimeve; kërkesa për lëndë plasëse e paargumentuar; numri i mjeteve apo certifikatave të cilat nuk kanë lidhje me zërat e punimeve që do të kryhen, etj). Këto shkelje u konstatuan **në 5 procedurat e prokurimit si më poshtë:**

1. Në tenderin me objekt: “Rehabilitimi i kanalit vaditës të Otomisë, Njësia Administrative Poroçan”, me fond limit 18,889.139 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 17.02.2017 dhe lidhje kontrate nr. 2274 regj., datë 03.04.2017.

a.Nga NJP është kërkuar në mënyrë të paargumentuar paraqitja e vërtetimit për shlyrjen e taksave vendore për vitin 2015-2016 me afet vlefshëmrie 10 ditë para tenderit.

b. Ka kërkuar në mënyrë të paargumentuar posedimin e Certifikatave ISO nga çdo operator ekonomik në rast bashkimi, ndërkohë që duhen kërkuar në raport me përqindjen e punimeve që merren përsipër.

c. Ka kërkuar në mënyrë të paargumentuar 70 punonjës për secilin muaj për periudhën Janar 2014-Nëntor 2016.

2. Në tenderin me objekt: “Rehabilitim i rrugës Kodër Zgjupe-Sult, Njësia Administrative Sult”, me fond limit 8,332,403 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.04.2017 dhe lidhje kontrate nr. 3695 regj., datë 29.05.2017;

a. NJP ka hartuar kërkesat për kualifikim pa i argumentuar ato. NJP duhet të dokumentonte nëpërmjet një procesverbali kriteret teknike dhe ligjore nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

b. NJP ka kërkuar në mënyrë të paargumentuar nga OE që të disponojnë Autorizim të vlefshëm për përdorimin e lëndëve plasëse. Nuk ka asnjë zë në punime që të kërkojë disponimin e një autorizimi të tillë.

3. Në tenderin me objekt: “Rikonstruksion i lagjes “Akhensia” Gramsh”, me fond limit 10,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.07.2018 dhe lidhje kontrate nr. 5861 regj., datë 10.09.2018.

a. NJP ka hartuar kërkesat për kualifikim pa i argumentuar ato. NJP duhet të dokumentonte nëpërmjet një procesverbali kriteret teknike dhe ligjore nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

b. NJP ka kërkuar në mënyrë të paargumentuar nga OE që të disponojnë Autorizim të vlefshëm për përdorimin e lëndëve plasëse. Nuk ka asnjë zë në punime që të kërkojë disponimin e një autorizimi të tillë.

4. Në tenderin me objekt: “Rikonstruksion i lagjes “Akhensia” Gramsh”, zhvilluar me datë 30.07.2018 dhe lidhje kontrate nr. 5861 regj., datë 10.09.2018 si më poshtë:

a. NJP ka hartuar kërkesat për kualifikim pa i argumentuar ato. NJP duhet të dokumentonte nëpërmjet një procesverballi kriteret teknike dhe ligjore nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

b. NJP ka kërkuar në mënyrë të paargumentuar një numër të lartë prej 60 punonjësish. Për procedura të njëjta apo edhe në vlerë disa herë më të lartë, NJP ka kërkuar një numër më të reduktuar punonjësish. Nuk argumentohet ky numër i lartë me volumet e punës.

c. NJP ka kërkuar në mënyrë të paargumentuar 1 inxhinier elektrik, 1 inxhinier mekanik dhe inxhinier hidroteknik, ndërkohë që nuk ka zëra punimesh për këtë kategori inxhinieresh.

d. NJP ka kërkuar në mënyrë të paargumentuar një numër të lartë specialistësh prej 20 punonjësish me kualifikime me IQT, ku për disa prej tyre nuk ka zëra punimesh për prezencën e tyre.

e. NJP ka kërkuar në mënyrë të paargumentuar mjete dhe pajisje teknike si 3 kamionë, 3 kamionçina, 2 fadroma me goma, telehender/pirun, ndërkohë që nuk justifikohen me volumin e punimeve një numër kaq i madh mjetes.

5.Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës automobilistike nga fshati Shemrizë deri tek ura Skenderbegas”, zhvilluar me datë 23.02.2017 dhe lidhje kontrate nr. 2101 regj., datë 30.03.2017; me fond limit 71,756,881 lekë.

a. Ka kërkuar në mënyrë të paargumentuar licencat profesionale **NP-1C, NP-5C, NP-6B, NP-7C, NP-8A, NP-9C, NP-10A, NP-11C, NP-12C, NS-1B, NS-2C, NS-4C, NS-8A, NS-13A, NS-14B, NS-16A, NS-17A.**

b.Ka kërkuar në mënyrë të paargumentuar posedimin e *Certifikatave ISO* nga çdo operator ekonomik në rast bashkimi, ndërkohë që duhen kërkuar në raport me përqindjen e punimeve që merren përsipër.

c. Ka kërkuar në mënyrë të paargumentuar 1 inxhinier elektrik, 1 inxhinier hidroteknik, 1 inxhinier mekanik. 1 inxhinier elektronik, 1 inxhinier pyjesh dhe 1 arkitekt, 5 specialistë ndërtim, 3 hidraulikë dhe 2 elektrikistë.

d. Ka kërkuar në mënyrë të paargumentuar 15 kamionë, 4 grejder, ekskavator me krahë 16 m, 4 ekskavator me zinxhirë.

II. Nga auditimi rezulton se Komisioni i Vlerësimit Ofertave (KVO), për 6 procedurat e prokurimit, ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me OE/BOE e tjerë, ku çdo mungesë në dokumentacion, sado e vogël, të konsiderohet mos përmbushje e kërkesave në DST, si edhe faktin që në nenin 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, gëjkojmë se vendimet e marra nga KVO për shpalljen fitues të 6 operatorëve ekonomikë edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (këtu e në vijim AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (këtu e në vijim NJHDT), duke mos anuluar këto procedura, veprime këto me impakt negativ në buxhet për procedurat e prokurimit të shpallura dhe mos përputhje me dispozitat e ligjit të prokurimit publik dhe shpallur fitues me kriteret të paplota e konkretisht, janë në kundërshtim me:

- nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa (c, ç, d, dh), nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”,

-nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, si dhe nenin 66, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Këto shkelje u konstatuan në 6 procedurat e prokurimit si më poshtë:

1.Në tenderin me objekt: “Ndërtim i urës tip BAILEY, përroi Gurrës, fshati Poroçan”, me fond limit 7,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20.02.2017 dhe lidhje kontrate nr. 2097 regj., datë 30.03.2017;

a.KVO ka kualifikuar BOE "P." dhe "B." shpk në mos përmbushje të pikës 4/d të kriterëve teknike pasi nuk ka paraqitur librezën e punës për mjekun e shoqërisë; nuk ka paraqitur librezat e punës për 2 montatorë, për 2 elektrikistë, si dhe nuk ka paraqitur diplomën, librezën e punës dhe CV-në për inxhinierin e ndërtimit me IQT z.B.U sipas pikës 4/a, c, d.

b.Operatorët ekonomikë, kanë deklaruar 2 kamionë të marrë me kontratë qiraje me mangësi në dokumentacion pasi u mungon Certifikata e Transportit për të Tretë dhe me Qira.

c.OE "P." shpk nuk ka paraqitur asnjë nga Certifikatat ISO të kërkuara në DST.

2. Në tenderin me objekt: "Rehabilitim i rrugës Kodër Zgjupe-Sult, Njësia Administrative Sult", me fond limit 8,332,403 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 21.04.2017 dhe lidhje kontrate nr. 3695 regj., datë 29.05.2017;

a.KVO ka kualifikuar OE "R. G-K." shpk i cili nuk plotëson pikën 5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi nuk ka paraqitur Aktin e pronësisë së mjeteve dhe konkretisht për 1 fadromë, 2 kamionë dhe 2 kamionçina.

3. Në tenderin me objekt: "Rehabilitim i rrugës Devoll" me fond limit 63,562,371 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 19.06.2017 dhe lidhje kontrate nr. 5032 regj., datë 18.07.2017;

a.KVO ka kualifikuar BOE "A." shpk dhe "E." shpk të cilën nuk plotësonin pikën 4 të DST pasi për stafin e specialistëve nuk ka paraqitur dëshminë e kualifikimit të lëshuar nga IQT siç është kërkuar nga NJHDT.

b.Ka paraqitur 1 autobot uji, ndërkohë që kërkohej 2 të tillë në DST.

c.Një numër i madh mjetesh të paraqitura nga ky BOE rezultojnë të deklaruara në të njëjtën kohë në kontratën e prokurimit "Për rikonstruksionin e rrugës nga fshati Shemrizë deri tek Ura Skenderbegas".

d.Ka paraqitur 2 kamionçina me kapacitet mbajtës poshtë kapacitetit të kërkuar 1-3.5 Ton.

e.Ka paraqitur dokumentacionin e një fadrome me probleme, pasi rezultojnë dokumente të një autoveture.

f.Një numër i madh mjetesh të marra me qira nga ky BOE rezulton se u mungon Certifikata e Transportit për të Tretë dhe me Qira.

4. Në tenderin me objekt: "Rikonstruksion i objektit shkollë 9 – vjeçare "Këshilltarët e Galigatit", Njësia Administrative Pishaj", me fond limit 5,000,000 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 28.07.2017 dhe lidhje kontrate nr. 5710 regj., datë 30.08.2017;

a.KVO ka kualifikuar BOE "L. K." shpk dhe "M." shpk të cilët nuk plotësonin pikën 4 pasi OE "M." shpk nuk ka paraqitur dokumentacion për mjekun e shoqërisë.

b.Mjetet e marra me kontratë qiraje u mungon Certifikata e Transportit për të Tretë dhe me Qira.

c.Disa nga mjetet e deklaruara për zbatimin e kësaj kontrate, rezultojnë të deklaruara në të njëjtën kohë në kontrata tjera të lidhura pranë këtij Autoriteti Kontraktor.

5. Në tenderin me objekt: "Rikonstruksion i shkollës 9 – vjeçare "Koli Baba", me fond limit 10,8383,000 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 16.07.2018 dhe lidhje kontrate nr. 5173 regj., datë 17.08.2018;

a.KVO ka kualifikuar BOE "A." shpk dhe "Sh." shpk të cilët nuk plotësonin pikën 2.3.5 të DST pasi inxhinieri hidroteknik i OE "A." shpk z. A.Xh nuk figuron në listpagesat e shoqërisë për vitin e fundit, pikën 2.3.6 të DST pasi mjeku i OE "A." shpk nuk figuron i punësuar 12 muajt e fundit pranë këtij OE.

b.Janë paraqitur një numër mjetesh të marra me kontratë qiraje për të cilët mungon Certifikata e Transportit për të Tretë dhe me Qira.

6. Në tenderin me objekt: "Sistemim asfaltim i lagjes 85", me fond limit 54,520,000 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 11.06.2018 dhe lidhje kontrate nr. 4577 regj., datë 16.07.2018;

a.KVO ka kualifikuar OE "M." shpk i cili ka paraqitur me mangësi mjetet për zbatimin e kësaj kontrate pasi mjetet e marra me kontratë qiraje u mungon Certifikata e Transportit për të Tretë dhe me Qira, konkretisht 4 kamionë, 3 autobetoniere, 2 kamionçina, 2 autobotë uji dhe 1 fadromë.

b.Për mjetin miniekskavator nuk ka paraqitur kontratën e shitblerjes apo aktet e zhdoganimit siç kërkohet në DST.

SHENIM I KRYETARIT TË KLSH: Mbështetur në dhënien e Opinionit të Kundërt, mbas rivlerësimit me grupin e Auditimit, Kryeaudituesin, Juristit të Departamentit dhe Drejtorit të Sigurimit të Cilësisë, materiali për shkeljet të procedurave të prokurimeve, trajtuar më hollësisht në pikën IV/D. “Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797 datë 29.12.2017) faqet 67-104, të Raportit Përfundimtar të Auditimit), **përcillet si INDICIE PENALE, në Prokurori.**

Gjithashtu, për arsye të mos përmbushjes plotësisht të objektivave të auditimit, mospërcaktimi i saktë dhe i plotë i dëmit ekonomik dhe efektivitetit ekonomik në fushën e investimeve publike, auditimi për zbatimin e procedurave ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik **do të përsëritet** brenda 6-mujorit të parë të vitit 2020 në auditimin e radhës.

p.s. Me shkresën nr. 200/8 prot, datë 22.08.2019 dërgohen praktikat e mësipërme të prokurimit për veprime të mëtejshme procedurale, për tu studiuar si Indice Penale nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R